

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 27 JANAR 2022

Përshëndetje!

Të dashur qytetarë,

Është shumë e rëndësishme të ndalemi tek akti normativ dhe të japim informacionet e duhura, të sakta dhe jo dehje me komente pafund, siç bëri zonja Tabaku. Sigurisht, për secilin nga ju është e nevojshme të kalojë nga një temë në tjetrën dhe për ta përdorur këtë foltore për këdo politike, por ne kemi një detyrim ndaj qytetarëve, ndaj biznesit, sepse është shumë e rëndësishme dhe e ndihmon atë nëse e informon siç duhet atë për masat që po merren. Ju, zonja Tabaku, thatë se nuk është bërë asnjë gjë, por, në fakt, jeni ju që keni refuzuar të merrni pjesë në të gjithë aprovimin e ligjeve të paketës MONEYVAL ose edhe të procesit të fiskalizimit, një ligj i cili nuk është bërë për të kënaqur një palë apo një tjetër, por për rritur formalizimin e ekonomisë, për të rritur të ardhurat, për t'i çuar ato të ardhura tek atë grup që ka më shumë nevojë dhe për ta mbështetur edhe uljen e borxhit afatmesëm.

Megjithatë, ju në komisionet parlamentare refuzoni t'i aprovoni këto procedura, por vetëm vini dhe kritikoni proceset teknike, për të cilat çdo proces teknologjik do të kishte vështirësi. Çfarë po aprovojme sot në këtë akt normativ për procesin e fiskalizimit? Po aprovojme shtyrjen e zbatimit të penaliteteve. Nuk janë penaltete që vihen rishtazi, përkundrazi janë penaltete që ligji i procedurave administrative i njej, por, pikërisht nga qasja proaktive që ka administrata tatimore, kërkon që biznesi ta adaptojë teknologjinë në kohën optimale dhe për këtë periudhë kohe të mos ketë penaltete. Çfarë të keqe ka në këtë proces? Pse në komisionet parlamentare nuk aprovohet pozitivisht nga përfaqësuesit tuaj kjo mbështetje për biznesin? Pse kur aprovohen 7 ligjet e paketës MONEYVAL nuk ka pjesëmarrje aktive nga opozita, por vini këtu dhe thoni se qeveria nuk ka bërë asgjë për të luftuar dhe për të mbështetur të gjithë luftën kundër evazionit? Atëherë, është shumë e qartë, është një dehje dhe përdorimi i kësaj foltoreje është për të bërë politikë, por jo për të ndihmuar të gjithë procesin më të gjitha instrumentet që kemi. Sot ne flasim për një shtyrje 6-mujore të aplikimit të gjobave. Nuk flasim, zoti Agalliu, për asnjë shtyrje të procesit të fiskalizimit. Procesi i fiskalizimit ka pasur vetëm një ndryshim, i cili është bërë në vitin 2020, kur si rezultat i pandemisë, në mbështetje të të gjithë biznesit, ka ndryshuar jo vetëm afati i aplikimit të tri fazave, por edhe radha. Ne nuk e nisëm nga marrëdhënia biznes-konsumator, por e nisëm nga marrëdhënia biznes-qeveri, pastaj biznes-biznes dhe, së fundi, biznes-konsumator.

Ky ligj është shtyrë edhe më parë në vitin 2019, nuk ka asnjë arsye dhe asnjë argument, por duhet ta mbështesni, se kur e shikoni që ky ligj është korruptiv të sillni argumente. Ky një ligj është i konsultuar me të gjitha grupet e interesit dhe ka marrë mbështetje nga të gjitha grupet e interesit. Ne po përmirësojmë një ligj, që sjell finalizimin e një procesi të formalizimit në ekonomi. A do të ishte e lehtë? Jo. A do të kërkojë kohë? Po. Vetëm përditësimi i sistemeve në një sistem bankar kërkon një ditë kohë, jo më një proces fiskalizimi për të realizuar një objektiv madhor, siç është rritja e të ardhurave. Prandaj, ftesa është të mos bëjmë demagogji, as politikë kur vjen puna për rritjen e ekonomisë në ato nivele të formalizimit që të gjithë ne i synojmë dhe kërkojmë. Së fundi, kur flasim për ftesën për pjesëmarrje aktive, dua t'ju përmend, zonja Tabaku, edhe veprimet e ndodhura në komisionin hetimor të inceneratorëve. Ju jeni drejtuese, kemi qenë deri në datën 28 dhe jo vetëm

fakti se 5 mbledhje janë bërë në 3 muaj, por edhe kërkesën që iu bë për të thirrur dëshmitarë ju e refuzuat. Prandaj, ju lutem shumë, kur përdorni foltoren për të keqinformuar, përmendini të gjitha detajet dhe jo vetëm demagogji. Faleminderit!